

Akt Themelimi i shoqërisë tregtare "Dukagjini Albania" shpk

Sot me date 09.09.2025, Shoqëria e te drejtës kosovare Dukagjini shpk, regjistruar me numër unik identifikues 810418922, me seli në Pejë, rr. Ismail Qemali nr. 2, Kosovë, e përfaqësuar nga z. Ekrem Lluka, shtetas shqiptar, i biri i Kurteshit dhe Behijes, lindur në Pejë dhe banues në Pejë, Kosovë, lindur më 11/10/1959, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i dokumentit të identifikimit me nr. 033912313 dhe nr. personal F91011089, titullarë e 100 % të pjesëmarrjes në kapital, ka themeluar shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"Dukagjini Albania" shpk**

Neni 1 Themelimi

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar të quajtur **"Dukagjini Albania" shpk**. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë degë. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të legjislacionit në fuqi, aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë.

Neni 2 Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 1 000 000 (një milion) Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në 1 kuotë të zotëruar nga ortakët e vetëm, shoqëria e te drejtës kosovare Dukagjini shpk, zotëruese e 1 kuote, të barazvlefshme me 1 000 000 leke (një milion), të barabartë me 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;

Neni 3 Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë ligjore të regjistruar në adresën: Tiranë, Rr. Elbasanit, Zona Kadastrale nr.8160, Nr.Pasurie 6/359-N3.

Neni 4 Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet me objektin e mëposhtëm:

- Botimi i veprave të ndryshme dhe në vecanti botimin e librave dhe materialeve shkollore dhe universitare, veprave letrare, veprave të ndryshme artistike etj. Botimet do të kenë shpërndarje të gjera brenda dhe jashtë vendit dhe ato do të marrin formë të ndryshme duke filluar nga forma tradicionale e letres së shtypur deri në format moderne elektronike.
- Aktiviteti i shoqërisë nuk do të kufizohet vetëm me zërat e lartpërmendura, por do të përfshijë çdo veprim që do të lidhet me përgatitjen e botimit, reklamen dhe shpërndarjen e veprave të botuara, qofshin ato libra, revista, gazeta apo të tjera, të çfaredolloj forme të mundshme.
- Shitje online të çdo botimi në formë letrare dhe elektronike, botime të veprave shkollore dhe letrare për diasporën.
- Trajnime profesionale të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar dhe universitar, konsulence, kurse afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e edukimit profesional për specialistë të fushave të ndryshme të mesimdhënisë,
- Shoqëria do të merret me shërbime si organizimin dhe ndërmjetësimin për konferenca, seminare, aktivitete artistike-kulturore.
- Çdo veprimtari tjetër të ngjashme ose plotësuese të veprimtarisë si më sipër.

Neni 5 Kohezgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar

81

Neni 6

Administratore

Administrator i shoqërise do të jetë z. Gert Guri, i biri i Fuat, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë rr. M. Grameno P.88 Sh.1 Ap.1; Njësia Administrative Nr. 2, lindur më 11/06/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033952014 dhe nr. personal I10611170W.

Administratori i emëruar si me sipër do të ushtrojë këtë funksion për një periudhë prej 5 vitesh dhe do të ketë të drejtat dhe kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi, pa asnjë kufizim.

Neni 7

Viti Financiar

Viti financiar i shoqërise fillon me 01.01 të çdo viti dhe përfundon me 31.12 të çdo viti.

Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në Regjistrin Tregtar dhe mbyllet me 31 dhjetor të po atij viti.

Neni 8

Baza ligjore

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 10

Dispozita përfundimtare

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje në gjuhën shqipe dhe angleze, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërise **Dukagjini Albania shpk**.

ORTAK I VETEM

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Dukagjini Albania" shpk

Shoqëria Dukagjini shpk

Përfaqësuar nga

Ekrem Lluka

